



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:032659

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05607147

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, sipas gjyqtarit Musë Povataj me pjesëmarrje e bashkëpunëtores profesionalë Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit Ç.. K., për shkak veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.930/18 e datës 25.06.2018, duke vepruar sipas detyrës zyrtare me datë 23.04.2024 bie këtë:

**A K V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr.930/18 e datës 25.06.2018.

**PUSHOHET** procedure penale ndaj të akuzuarit Ç.. K.. i lindur me 13.01.2000 ne fsh L.. P., me vendbanim të fundit ne fsh L.. K. P., i biri i R., nënës N, e gjinisë L.. me profesion i pa pune , gjendjes së mesme ekonomike, me nr. te letërnjoftimit ....., shqiptar , shtetas i Republikës së Shqipërisë.

- për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

**A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzën, PP/II.nr.930/18 e datës 25.06.2018, kundër të pandehurit Ç.. K., për shkak veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPRK-së.

Gjykata me datën 13.04.2023, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor e cila nuk është mbajtur ne mungesë të të pandehurit., ndërsa sipas raporti të Policisë të datës 03.05.2023 është konstatuar

se i pandehuri gjendet ne Gjermani, ndërsa me datën 11.05.2023 është lëshuar urdhër arrest ndaj të pandehurit.

Prandaj gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka gjetur se në këtë çështje penale ka arritur afati i parashkrimit apsolut i ndjekjes penale dhe atë me datë 20.04.2024 ndaj të akuzuarit Ç.. K.. për shkak veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 të KPRK-së,

Sipas aktakuzës i pandehuri është akuzuar për veprën penale nga neni 188 par. 2 të KPRK-së për të cilëve veprë është paraparë dënimi me burgim deri ne 3 vite.

Andaj gjykata ka vlerësuar se është i pa kontestueshëm fakti se aktakuza e Prokurorit të Shtetit PP/II.nr.930/18 e datës 25.06.2018 është parashkruar me datë 20.04.2024, ndaj të pandehurit, pasi kanë kaluar 6 vite nga koha e kryerjes së veprës penale me datë 20.04.2018, e për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në 3 vite sipas kodit të aplikueshëm ne kohen e kryerjes se veprës penale ( Kodi nr. 04/L-129).

Me depozitën ligjore të nenit 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së është paraparë se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me me shumë se një vite burgim. Ndërsa dispozita ligjore e nenit 107 par. 8 të KPRK-së ka përcaktuar se ndjekja penal ndalohet ne çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 KPP-së.

Prandaj nga arsyet e cekura me lartë gjykata ne kuptim te nenit të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2018:032659, 23.04.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Edona Berisha Kastrati**

\_\_\_\_\_  
**Musë Povataj**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 10 ditësh pas marrjes, gjykatës se Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate.